

HAMIT KABA

**RELACIONE SHQIPTARO-AMERIKANE
(1939-1943)***

Në dallim nga Britania e Madhe, Ballkani dhe Shqipëria si pjesë e tij, gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk përfaqësonin ndonjë rajon të veçantë për interesat amerikane, është një gjë tashmë një e vërtetë e mbështetur nga dokumentet arkivore dhe pranuar nga shumë historianë¹. Pavarësisht nga fakti që SHBA hynë në Luftën e Dytë Botërore në dhjetor 1941, pas sulmit japonez në Pearl Harbour, ata u përfshinë indirekt në të edhe përpara kësaj date. SHBA e dënuan pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste në prill 1939, dhe më vonë edhe të Greqisë dhe të Jugosllavisë. Ato dërguan misione ushtarake në Jugosllavi, Greqi dhe në Shqipëri, në vitin 1943, të cilët kontribuan dhe ndihmuan për rritjen dhe fuqizimin e rezistencës në këto vende dhe për harmonizimin e saj me operacionet e vendeve aleate. Por kontributi më i madh i SHBA, si pjesë e koalicionit të madh anglo-sovjeto-amerikan, ishte më evident në rajone të tjera të globit.

Për arsye të ndryshme, për rolin e Misioneve amerikane të Zyrës së Shërbimeve Strategjike (Office of Strategic Services – OSS) gjatë LDB në Ballkan është shkruar pak, dhe ca më pak për Shqipërinë. Vetëm këto 3 vjetët e fundit janë shkruar dy libra, një nga Peter Lucas² dhe tjetri nga Agnes Jensen Mangerich³ Njohja e këtyre botimeve si dhe e dokumenteve arkivore shqiptare dhe amerikane, të botuara dhe të pabotuara, më krijoi mundësinë që të paraqes para jush, në formën e një studimi të përmbledhur për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane gjatë periudhës së LDB.

Gjatë viteve të LDB nuk ka pasur bashkëpunim në nivelin shtetëror dhe diplomatik, sepse Shqipëria ishte një vend i pushtuar dhe marrëdhëniet

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore “Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 26 nëntor 2009.

¹ G.Lundenstad, *The American Non-Policy Towards Eastern Europe, 1943-1947*, Tromoso u.a.: 1978, p.96.

² Peter Lucas, *The OSS in World War II-Albania, Covert Operations and Collaboration with Communist Partisans*, North Carolina, USA: 2007.

³ Agnes Jensen Mangerich, *Albanian Escape. The True Story of U.S. army Nurses Behind Enemy Lines*, USA: 2006.

diplomatike ndërmjet të dy vendeve u ndërpre në pas pushtimit të Shqipërisë më 7 prill 1939 dhe largimit të detyruar të përfaqësisë diplomatike të SHBA nga Shqipëria, dhe analoges së saj shqiptare nga Uashingtoni. Interesi amerikan për Shqipërinë dhe rezistencën e saj u rrit në vitin 1943, kur në Shqipëri erdhi i pari Mision Ushtarak Amerikan, i cili u zgjerua dhe shtua në numër dhe detyra në muajt e mëpasshëm. Misioni amerikan krahas atyre të Britanisë së Madhe ndihmuan luftën antifashiste të popullit shqiptar.

Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane njohën një periudhë intensive zhvillimi në vitet 1945-1946, kur në Shqipëri gjendej një mision jo zyrtar i SHBA, i ngarkuar të studionte gjendjen e vendit dhe të procedonte më tej, me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Por për fatin e keq sidomos të shqiptarëve, marrëdhëniet diplomatike nuk u rivendosën, dhe ndërmjet të dy vendeve nuk pati marrëdhënie zyrtare deri në 15 mars 1991. Marrëdhëniet dypalëshe u rivendosën vetëm pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri.

Relacionet shqiptaro-amerikane gjatë pushtimit italian të Shqipërisë

Një moment i rëndësishëm në marrëdhëniet dy palësh shënoi pushtimi italian i vendit në 7 prill 1939. **Së pari**, në dallim nga qëndrimi i disa prej qeverive të shteteve fqinje të Shqipërisë dhe i Britanisë së Madhe, qeveria amerikane nuk e njohu pushtimin italian të vendit, dhe e dënoi atë përmes deklaratës së Sekretarit të Shtetit, të datës 8 prill 1939⁴. *“Pushtimi me forcë dhe me dhunë i Shqipërisë, theksohet në këtë deklaratë, është padyshim një kërcënim tjetër i paqes së botës. Do të ishte miopi po të mos i kushtojë kujdes më tej këtij zhvillimi. Çdo kërcënim i paqes shqetëson seriozisht të gjitha kombet dhe dhunon vullnetin e të gjithë popujve të botës, që qeveritë e tyre të mos i drejtohen luftës, por shtigjeve të paqes”* Deklarata amerikane u bë në kohën që SHBA i përmbaheshin parimit të mospërfshirjes në konfliktet e vendeve të tjerë, parim të cilin do ta risillte më me forcë Kongresi Amerikan më 4 nëntor të vitit 1939, kur do të miratonte “Aktin e Neutralitetit”. Sidoqoftë, ky ligj nuk i pengoi qeverinë amerikane që të reagoje dhe dënonte pushtimet e shteteve të Aksit, dhe t’u premtonte ndihma vendeve të pushtuara dhe të kërcënuara, si vepruan me Shqipërinë, Greqinë, Jugosllavinë etj. Periudha në prag dhe pas pushtimit të Shqipërisë u bë objekt diskutimesh, vëzhgimesh dhe vlerësimesh nga qeveria amerikane. Në këtë aksion u përfshi jo vetëm misioni amerikan në Shqipëri, i kryesuar nga Grant, por edhe vet presidenti Rusvelt, Sekretari i Shtetit etj. Presidenti Rusvelt, më 14 prill 1939, i kërkoi qeverisë italiane, që të tërhiqte trupat e pushtimit nga Shqipëria, dhe të mos sulmonte

⁴ <http://www.mtholyoke.edu/acad/intrel/WorldWar2/albania.html>; US Department of State, Publication 1983, *Peace and War: United States Foreign Policy*, p. 454.

dhe pushtonte territoret e kombeve të pavarura, duke sugjeruar si rrugëzgjdhje diskutimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Dokumentacioni amerikan, vë në dukje se qeveria amerikane kreu hetime pranë autoriteteve shqiptare në Tiranë, në Washington, në Romë, dhe po kështu në Jugosllavi, sepse dyshonte për ekzistencën e ndonjë neni apo klauzole, që mund të gjendej në marrëveshjet shqiptaro-italiane, i cila do të mund të justifikonte dhe përlligjte pushtimin e Shqipërisë nga Italia e Musolinit. Kordel Hull do të ndjehej i befusuar dhe njëkohësisht i zhgënjyer, kur mësoi se Traktati Italo-Jugosllav, përmbante një klauzolë që i jepte të drejtë Jugosllavisë, që të luanin rol të veçantë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Ndonëse SHBA e dënuan dhe nuk e njohën pushtimin e Shqipërisë, ato nuk e konsideruan rastin e saj të barasvlershëm me pushtimin e Çekoslovakisë, zhvillimet e së cilës sipas Sekretarit të Shtetit Kordel Hull, ishin të ndryshme nga ato të Shqipërisë. SHBA nuk i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Italinë, pas pushtimit të Shqipërisë, por u munduan të shmangnin përfshirjen e saj përkrah forcave të Aksit. Për këtë qëllim ato shfrytëzuan akordin amerikano-italian në fuqi si dhe lidhjet e komunitetit të madh italian në SHBA me shtetin e tyre të origjinës, Italinë. Më 23 gusht 1939, Presidenti Rusvelt do ti tërhiqte vëmendjen Musolinit që qeveria e tij të shmangte shpërthimin e *“një lufte të përbotshme që do të shkaktonte përballjen e të gjithë kombeve, pavarësisht se mund të jenë pjesëmarrës ose neutralë, fitues apo humbës...”*⁵

Rezistenca shqiptare sipas gjykimeve të diplomatëve amerikanë dhe të vet mbretit Zog, ishte një protestë kundër agresionit italian dhe një demonstrim për botën, me qëllim që të sigurohej mbështetja e tyre, por jo më shumë. Amerikanët nuk premtuan ndihma për rezistencën e shqiptarëve në kohën e pushtimit italian, siç ndodhi në rastin e pushtimit të Greqisë dhe të Jugosllavisë, për shkak të vet shkallës së qëndresës së shqiptarëve, e cila konsiderohej më shumë demonstrative se sa një rezistencë reale. Kreu i misionit amerikan në Shqipëri, Grant do ti relatonte Departamentit të Shtetit për luftimet kundër pushtimit italian në Shqipëri, të cilat sipas tij, ishin ekzagjeruar nga zyra e shtypit shqiptar⁶. Padyshim në gjykimin tonë duhet të kemi parasysh se deklaratat ndaj pushtimit të Greqisë dhe Jugosllavisë u bënë në periudhën kur kishte filluar Lufta e Dytë Botërore dhe ndërmjet tyre dhe Britanisë së Madhe ekzistonin marrëveshje të posaçme, gjë që nuk mund të thuhet për vendin tonë.

Së dyti, dokumentet amerikane na japin të dhëna të rëndësishme për gjykimet e mbretit Zog, mbi forcën e shtetit shqiptar dhe imazhin e tij ndërkombëtar në kohën e pushtimit. Tentativat e Zogut për të siguruar nga shtete fqinje të Shqipërisë, si Turqia, Jugosllavia, Rumania dhe Greqia një

⁵ *Po aty*, f. 474-476.

⁶ *Po aty*, f. 380, Telegram i Grant për Departamentin e Shtetit, Tiranë më 8 prill 1939.

deklaratë kolektive kundër pushtimit italian të vendit të tij, dështuan. Mbreti bëri demarshe edhe tek Franca dhe Britania e Madhe, duke pasur në konsideratë interesat e tyre në Mesdhe, por sërish ato dështuan. Shqipëria e pushtuar mendonte mbreti Zog, do të shërbente si “pedanë” për të vazhduar me pushtime të tjera në Ballkan, gjë që u vërtetua në tetor 1940, kur Italia e Musolinit sulmoi Greqinë. Ministri grek në Tiranë do ta konsideronte të vonuar, apelin e shqiptarëve për deklaratën kolektive të vendeve ballkanike. Granti, nëpërmjet telegramit që i përcjelli Uashingtonin në lidhje me takimin e tij me Zogun më 6 prill 1939, do të vinte në dukje qortimin e mbretit Zog që demokracitë, duhej të tregoheshin më të vendosura, për tu përballuar me shtete totalitare, të cilat mund të gllabëronin në të ardhmen edhe shtete të tjerë të vegjël përveç Shqipërisë. Zogu ishte gjithashtu realist kur shprehte opinionin se, rasti i vendit të tij nuk do të sillte ndërlkime të mëdha të qarqeve ndërkombëtare. Imazhi i Shqipërisë në sytë e ndërkombëtarëve, ishte i dobët. Bashkëpunimi i ngushtë me Italinë, ndonëse i orientuar nga ndërkombëtarët, e kishte zbehur shumë mëvetësinë e shtetit shqiptar, figurën e tij politike dhe forcën e tij ushtarake. Siç rezultojnë nga dokumentet, italianët ishin futur thellë në problemet e brendshme të vendit, dhe përmes rrugëve korruptive, i kishin bërë për vete disa nga ndihmësit e Zogut. Zogu, komentonte Grant, ndjehej i tradhtuar në prag të pushtimit. Por indiferenca e vendeve ballkanike ndaj pushtimit të Shqipërisë, u kushtëzua edhe nga një lloj garancie që ata kishin nga të mëdhenjtë, për shkak të pakteve të nënshkruara me ta, por edhe të frikës dhe pafuqisë për të përballuar Italinë fashiste, e cila mendohej se ishte superiore ndaj tyre. Për demokracitë perëndimore si Britania e Madhe dhe Franca, pushtimi i Shqipërisë nuk paraqitej aq i rëndësishëm sa të prishnin ekuilibrat dhe marrëdhëniet me Italinë, për të cilën shpresohesh që të mos angazhohej përkrah forcave të Boshtit, i cili po përvijohesh në këtë kohë. Ndërsa Bashkimi Sovjetik vetëm disa muaj më pas do të nënshkruante në Moskë, paktin Ribentrop-Molotov me Gjermaninë e Hitlerit, e cili do të siguronte një farë qetësie për gati dy vjet. Duke studiuar qëndrimin e qeverisë franceze dhe angleze, ambasadori amerikan do të përcillte nga Parisi mesazhin se “qeveria britanike do të vendosë që të mos bëjë asgjë më shumë se sa të bëjë më të mirën e një pune të keqe. Në të vërtetë, shtonte ai më tej, *as Britania e Madhe dhe as Franca nuk kanë ndonjë qëllim që të shkojnë në luftë për çështjen shqiptare*”⁷.

Së treti, Qeveria amerikane, ndonëse e dënoi pushtimin e Shqipërisë, ajo e tërhoqi misionin e vet nga Tirana, vetëm kur kjo gjë ju kërkua nga qeveria shqiptare dhe italiane, sepse MPJ e Shqipërisë do të suprimohej, dhe funksionet e saj do të ushtronin autoritetet italiane. Si rrjedhojë, Grant u urdhërua nga Uashingtoni që të mbyllte legatën në Tiranë dhe të kthehej në Uashington.

⁷ *Po aty*, f. 380, Telegram i ambasadorit amerikan në Paris Bullit për Departamentin e Shtetit, Paris 8 prill 1939.

Sidoqoftë, pas disa procedurave formale, legata u mbyll më 16 shtator 1939. Amerikanët ngarkuan legatën e tyre në Napoli të merrej me problemet e shqiptarëve. Që nga kjo datë dhe deri më 15 mars 1991, kur u rivendosën marrëdhëniet diplomatike, ndërmjet dy vendeve tona nuk ka pasur marrëdhënie zyrtare. SHBA asnjëherë nuk i ndërprejnë zyrtarisht marrëdhëniet dhe kontaktet me mbretin Zog, dhe qeveria amerikane nuk e njohu asnjëherë aneksimin e Shqipërisë nga Italia, dhe për më tepër nga viti 1942 deri në fund të nëntor 1944, ajo u shpreh publikisht për rezistencën e shqiptarëve duke e vlerësuar atë, në prag të pushtimit. Qëndrimi i ftohtë dhe indiferent ndaj pushtimit të Shqipërisë, ishte i lidhur edhe me interesat e shteteve të mëdha, të cilat nuk ishin përfshirë akoma në konfliktin e madh botëror dhe mundoheshin që Italinë ta neutralizonin ose ta kishin nga ana e vet. Shtete të tilla si Greqia, Jugosllavia apo vetë Britania e Madhe kishin marrëveshje të veçanta me Italinë, të cilat i penguan të shihnin rrezikun që po vinte.

